3. Shoqatat e ushtarakëve në rezervë dhe në lirim kanë të drejtë të anëtarësohen në Konfederatën Ndëraleate të Oficerëve në Rezervë e në Lirim të NATO-s (CIOR) dhe në organizata të tjera.

4. Shpenzimet për përballimin e pagesës së kuotës së anëtarësisë dhe pjesëmarrjes në veprimtaritë ndërkombëtare, që organizohen nga Konfederata Ndërraleate e Oficerëve në Rezervë e në Lirim të NATO-s (CIOR) përballohen nga Buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes.

Neni 44

Mbrojtja e veçantë ligjore

1. Jeta, figura dhe dinjiteti i ushtarakut dhe familjes së tij janë të paprekshme dhe mbrohen me ligj.

Gjatë kryerjes së detyrës dhe për shkak të saj, ushtarakut aktiv dhe në rezervë i garantohet mbrojtja e veçantë ligjore.

2. Ushtaraku aktiv nuk mund të ndalohet dhe të arrestohet nga Policia e Shtetit, përveç kur kapet në kryerje e sipër ose menjëherë pas kryerjes së një krimi të rëndë.

Ai ndalohet dhe arrestohet vetëm nga Policia Ushtarake, sipas legjislacionit në fuqi.

3. Në rastet kur ushtaraku aktiv ndalohet nga Policia e Shtetit, sipas pikës 2 të këtij neni, ajo menjëherë njofton Policinë Ushtarake.

4. Në rast se për shkak të detyrës që kryen ose ka kryer, familja ose pasuria e ushtarakut rrezikohen nga veprime të paligjshme, me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes atij i garantohet mbrojtje e veçantë nga struktura të Policisë Ushtarake deri në çastin e zhdukjes së rrezikut.

5. Çdo veprim që drejtohet kundër jetës, figurës dhe dinjitetit të ushtarakut dhe familjes së tij, dënohet sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 45

Ceremoniali ushtarak

1. Veprimtaritë përkujtimore, pritja e personaliteteve të vendit dhe të huaja zhvillohen me ceremoni ushtarake.

2. Në rast se ushtaraku aktiv, në rezervë, në lirim ose në pension vdes, varrimi kryhet me ceremoni ushtarake.

Shpenzimet e varrimit përballohen nga Ministria e Mbrojtjes. Instituti i Sigurimeve Shoqërore bën rimbursimin e Ministrisë së Mbrojtjes sipas kriterëve të përcaktuara në dispozitat ligjore.

3. Rregullat e ceremonialit ushtarak përcaktohen në "Rregulloren e ceremonialit ushtarak", e cila miratohet nga Ministri i Mbrojtjes me propozim të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

KREU V

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 46

Ristrukturimi

1. Në rast restrukturimi, kur bëhen ndryshime në strukturë dhe shkurtime në numrin e personelit të Forcave të Armatosura, ushtaraku, funksioni i të cilit shkurtohet dhe sistemimi ose emërimi në një detyrë tjetër, në përputhje me gradën dhe kualifikimin, është i pamundur, del në rezervë ose në lirim.

2. Ushtaraku i dalë në rezervë ose në lirim, siç përcaktohet në pikën 1 të këtij neni dhe që nuk plotëson kriteret për pension të parakohshëm, shpërblehet. Shpërblimi jepet në masën e pagës së plotë mujore për çdo vit të plotë shërbimi aktiv. Ky shpërblim jepet vetëm një herë dhe përcaktohet në urdhrin e daljes në rezervë ose në lirim.

Neni 47

Detyra dhe përgjegjësia e organeve shtetërore për sigurimin e statusit të ushtarakut

1. Institucionet qendrore vendore dhe komandat e njësive ushtarake, brenda kompetencave dhe në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve të tjera ligjore e nënligjore, sigurojnë realizimin e statusit të ushtarakut.

2. Për mosplotësimin e detyrimeve që përcaktohen në këtë ligj personat përgjegjës mbajnë, sipas rastit, përgjegjësi disiplinore, civile dhe penale, të cilat përcaktohen me dispozita ligjore.

3. Ministria e Arsimit dhe e Shkencës planifikon për çdo vit, në bazë të kërkesës së Ministrisë së Mbrojtjes, të drejta studimi për në fakultetet e shkollave të larta të Republikës së Shqipërisë, për fëmijët e ushtarakëve që kanë humbur jetën në detyrë ose për shkak të detyrës.

Neni 48

Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Këshilli i Ministrave, brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet e nevojshme për zbatimin e neneve 20, 21, 25, 27, 28 pika 2, 29 pika 2, 32 pika 7, 38 dhe 39 të këtij ligji.

2. Këshilli i Ministrave, brenda 24 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet e nevojshme për zbatimin e neneve 37 pikat 1 dhe 2, 40 dhe 41 të këtij ligji dhe të paraqesë ndryshimet përkatëse në ligjin nr.8087, datë 13.3.1996 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ Shtetëror", i ndryshuar, në zbatim të neneve 35 dhe 36 të këtij ligji.

3. Ministria e Financave, Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale dhe Ministria e Mbrojtjes, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, në bashkëpunim me njëra-tjetrën të nxjerrin udhëzimin e përbashkët për zbatimin e nenit 24 pika 6 të këtij ligji.

4. Ministria e Arsimit dhe e Shkencës dhe Ministria e Mbrojtjes, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, në bashkëpunim me njëra-tjetrën të lidhin një aktmarrëveshje për zbatimin e nenit 47 pika 3 të këtij ligji.

5. Ministria e Mbrojtjes, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet e nevojshme për zbatimin e neneve 10 pika 3, 19 pika 2, 31 pika 1, 33 dhe 45 të këtij ligji.

Neni 49

Shfuqizime

Ligji nr.7496, datë 3.7.1991 "Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", neni 50 i ligjit nr.7978, datë 26.7.1995 "Për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", shprehja "por jo më shumë se masa e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi" në shkronjën "b" të nenit 11 të ligjit nr.8087, datë 13.3.1996 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ Shtetëror", i ndryshuar, si dhe të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore, që janë në kundërshtim me kërkesat e këtij ligji, shfuqizohen.

Neni 50

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4204, datë 14.4.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

LIGJ
Nr.9211, datë 25.3.2004

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË MARRËVESHJEN EUROPIANE
“PËR SHËNIMIN E RRUGËVE”, GJENEVË,1957

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në Marrëveshjen Europiane “Për shënimin e rrugëve”, Gjenevë, më 13 dhjetor 1957.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4205, datë 14.4.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

E/ECE/303
E/ECE/TRANS/501

KOMISIONI EKONOMIK PËR EUROPËN
KOMITETI I TRANSPORTIT TOKËSOR

MARRËVESHJA
EUROPIANE PËR SHËNIMIN E RRUGËVE, BËRË NË GJENEVË, MË 13 DHJETOR 1957

Palët Kontraktuese,
duke dëshiruar të kontribuojnë mbi sigurinë e trafikut rrugor ndërkombëtar me anë të uniformitetit të shenjave të rrugës,
kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

1. Me qëllim të kësaj Marrëveshjeje:

a) Termi “shenja të rrugës” nënkupton shenjat mbi sipërfaqen e rrugëve udhëtuese ose në pjesët e saj ndihmëse, si anësoret e rrugëve, rrugica kalimtarësh, bordurat për udhëzim dhe rregullim ose për përdoruesit e rrugës.

b) Termi: “sipërfaqe e shënuar” nënkupton shenjat e rrugëve mbi sipërfaqen e rrugëve udhëtuese.

2. Me qëllim të kësaj Marrëveshjeje, shenjat e sipërfaqes do të klasifikohen si më poshtë:

- a) shenja gjatësore
- b) shenja tërthore
- c) shenja të tjera

Neni 2

1. Shenjat gjatësore konsistojnë në vija të vazhdueshme dhe në vija të ndërprera.
2. Kur shenjat gjatësore konsistojnë në vija të vazhdueshme nuk lejohet asnjë automjet të kalojë në anën tjetër të tyre ose të kalojë sipër tyre. Përgjatë nga ky rregull mund të bëhet vetëm me anë të autorizimit të secilës Palë Kontraktuese dhe kur është e nevojshme për të dhënë akses gjatë rrugës.
3. Kur shenjat gjatësore konsistojnë në vija të ndërprera, automjetet janë të lejuara të kalojnë në anën tjetër të tyre, duke siguruar respektimin e rregullave të trafikut. Vijat e ndërprera mund të jenë të formave të ndryshme, në përputhje me kushtet dhe rrethanat.
4. Kur shenjat gjatësore konsistojnë në linja të vazhdueshme në afërsi të një vije të ndërprerë, ajo nënkupton linjën më të afërt tek automjeti në fillim të manovrës.

Neni 3

1. Shenjat gjatësore konsistojnë në vija të vazhdueshme dhe në vija të ndërprera.
2. Kur një shenjë tërthore konsiston në një vijë të vazhdueshme që kalon në një ose më shumë rrugëkalime, ajo duhet të tregojë vijën pas së cilës drejtuesi i automjetit duhet të ndalojë kur vepron në përputhje me një shenjë “Ndalo kryqëzim”, me anë të një treguesi të dhënë nga një sinjal i semaforit të trafikut ose të një kontrollori trafiku, ose me anë të një rregulluesi tjetër të trafikut.
3. Një shenjë tërthore që konsiston në një vijë të ndërprerë mund të përdoret në rastet e treguara në rekomandimet e adoptuara në mbledhjen në të cilën përfaqësuesit e Palës Kontraktuese kanë marrë pjesë ose që janë ftuar të marrin pjesë.

Neni 4

Shenja të tjera në sipërfaqe, si shigjeta, vija paralele të pjerrëta ose fjalë të vizatuara në rrugët e udhëtimit mund të përdoren për të përsëritur treguesit e dhënë nga shenja vertikale ose për t'u dhënë përdoruesve të rrugës të dhëna, të cilat nuk janë të përshtatshme të jepen nga shenja vertikale.

Neni 5

Çdo Palë Kontraktuese mund të përdorë për shenja të rrugëve në formën e unazave, por në rastet e shenjave në sipërfaqe do të kërkohet me qëllim për të shmangur të gjitha mundësitë e konfuzionit, që unazat të vendosen në intervale të ndryshme për vijat e vazhdueshme dhe të ndërprera.

Neni 6

1. Shenjat e rrugëve në sipërfaqe duhet të jenë të verdha ose të bardha; më vonë, sidoqoftë, ato mund të zëvendësohen me hije si në ngjyrë argjendi ose në gri të lehtë.
 2. Kur përdoren të dyja ngjyrat në një shtet të veçantë njëra duhet të përdoret për shenjat që kanë për qëllim trafikun lëvizës të automjeteve sesa si vija kufizuese dhe tjetra mund të përdoret për shenjat që tregojnë parkim dhe rregullat në pritje.
- Dhe për vijat kufizuese shenjat që kanë për qëllim këmbësorët ose çiklistët, sidoqoftë duhet të jenë në të njëjtën ngjyrë.

Neni 7

1. Shenjat mund të përdoren në pjesët ndihmëse të rrugëve, veçanërisht në anësorët ose te bordurat, për të përmirësuar shikimin, veçanërisht natën të anësorëve ose të pengesave të rrugës. Ato gjithashtu mund të përdoren për të treguar zona ku ndalimi në pritje është i ndaluar ose për të dhënë tregime të tjera të ngjashme.

2. Çdo Palë Kontraktuese duhet të përdorë të njëjtën ngjyrë ose të përdorë kombinime të ngjyrave për të gjitha shenjat e rrugëve të të njëjtit tip në pjesët ndihmëse të rrugëve.

Neni 8

Gjatë procesit të vendosjes ose rinovimit të shenjave të rrugës, Palët Kontraktuese duhet të aplikojnë rekomandimet e adoptuara në mbledhjen në të cilën përfaqësuesit e Palëve Kontraktuese kanë marrë pjesë ose që janë ftuar të marrin pjesë.

Neni 9

1. Vendet anëtare të Komisionit Ekonomik për Europën dhe vendet e pranuar në Komision me cilësinë e konsulencës, sipas paragrafit 8 të Termave të Referencës së Komisionit, mund të bëhen Palë Kontraktuese në këtë Marrëveshje:

- a) duke e nënshkruar atë;
- b) duke e ratifikuar atë pas nënshkrimit, subjekt i ratifikimit;
- c) duke u pranuar në të.

2. Disa vende mund të marrin pjesë në disa aktivitete të Komisionit Ekonomik për Europën, në përputhje me paragrafin 11 të Termave të Referencës së Komisionit, mund të bëhen Palë Kontraktuese në këtë Marrëveshje duke e pranuar atë pas hyrjes së saj në fuqi.

3. Marrëveshja do të jetë e hapur për nënshkrim deri më 28 shkurt 1958. Pas kësaj ajo do të jetë e hapur për aderim.

4. Ratifikimi ose pranimi do të jetë efektiv duke depozituar ndonjë instrument te Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara.

Neni 10

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi ditën e nëntëdhjetë pasi pesë nga vendet e referuara në nenin 9 paragrafi 1 ta kenë nënshkruar atë pa rezerva ose ta kenë ratifikuar, ose të kenë depozituar instrumentet e tyre të ratifikimit ose të aderimit.

2. Për çdo vend që e ratifikon ose e pranon atë, pasi pesë vendet e kanë nënshkruar atë pa rezerva ose ta kenë ratifikuar, ose t'i kenë depozituar instrumentet e tyre të ratifikimit ose të aderimit.

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në ditën e nëntëdhjetë pasi vendet e sipërpërmendura t'i kenë depozituar instrumentet e tyre të ratifikimit ose të aderimit.

Neni 11

1. Çdo Palë Kontraktuese mund të denoncojë këtë Marrëveshje, duke njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

2. Denoncimi do të merret në konsideratë pesëmbëdhjetë muaj pas datës së marrjes së njoftimit të denoncimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 12

Kjo Marrëveshje nuk do të jetë efektive për një periudhë prej dymbëdhjetë muajsh në vazhdimësi pasi ajo ka hyrë në fuqi, kur numri i Palëve Kontraktuese është më pak se pesë.

Neni 13

1. Çdo vend, që në kohën e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje pa rezerva ose të ratifikimit ose të depozitimit të instrumenteve të tij ose të ratifikimit ose të aderimit në çdo kohë tjetër, mund të deklarojë duke njoftuar në adresë të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara se kjo

Marrëveshje do të shtrihet te të gjithë ose në ndonjë nga territoret për marrëdhënie ndërkombëtare për të cilat ajo është përgjegjëse.

Kjo Marrëveshje do të shtrihet në territorin ose territoret e emëruara në njoftim që nga dita e nëntëdhjetë e marrjes nga Sekretari i Përgjithshëm, ose nëse në këtë ditë Marrëveshja akoma nuk ka hyrë në fuqi, që nga hyrja e saj në fuqi.

2. Çdo vend i cili ka bërë një deklaratë sipas paragrafit 1 të këtij neni, duke e shtrirë këtë Marrëveshje në ndonjë territor për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilave ajo është përgjegjëse, mund ta denoncojë këtë Marrëveshje në mënyrë të veçantë në lidhje me këtë territor në përputhje me parashikimet e neni 11 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 14

1. Çdo mosmarrëveshje ndërmjet dy ose më shumë Palëve Kontraktuese, në lidhje me interpretimin ose aplikimin e kësaj Marrëveshjeje, duhet të zgjidhet sa të jetë e mundur me anë të bisedimeve ndërmjet tyre.

2. Çdo mosmarrëveshje e cila nuk mund të zgjidhet me anë të bisedimeve duhet të shtrohet para një gjykimi, nëse njëra nga Palët Kontraktuese në mosmarrëveshje e kërkon dhe duhet të referohet në një ose më shumë gjyqtarë të zgjedhur me marrëveshje ndërmjet Palëve në mosmarrëveshje.

Nëse brenda tre muajve nga data e kërkesës për gjykim Palët në mosmarrëveshje nuk kanë rënë dakord për zgjedhjen e një gjyqtari ose të gjyqtarëve, njëra nga këto Palë mund të kërkojë te Sekretarit i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara të emërojë një arbitër të vetëm ku të referohet mosmarrëveshja për t'u zgjidhur.

3. Vendimi i gjyqtarit ose i gjyqtarëve të caktuar sipas paragrafit 2 të këtij neni do të jetë i zbatueshëm për Palët në mosmarrëveshje.

Neni 15

1. Çdo Palë Kontraktuese, në kohën e nënshkrimit, ratifikimit ose aderimit të kësaj Marrëveshjeje, mund të deklarojë se ajo nuk e konsideron veten të detyruar nga neni 14 i kësaj Marrëveshjeje.

Palët e tjera Kontraktuese nuk do të jenë të detyruara nga neni 14 në lidhje me çdo Palë Kontraktuese e cila ka paraqitur një rezervë të tillë.

2. Çdo Palë Kontraktuese që ka paraqitur një vërejtje sipas paragrafit 1 të këtij neni në çdo kohë mund ta tërheqë një vërejtje të tillë duke njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

3. Asnjë vërejtje tjetër në këtë Marrëveshje nuk do të lejohet.

Neni 16

1. Çdo Palë Kontraktuese mund të propozojë një ose më shumë amendamente në këtë Marrëveshje. Teksti i çdo amendamenti të propozuar do të transmetohet te Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, i cili do ta transmetojë atë te të gjitha Palët Kontraktuese dhe të informojë të gjitha vendet e tjera në referim të nenit 9 paragrafi 1.

2. Çdo amendament i propozuar në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni do të gjykohet si i pranuar, nëse asnjë Palë Kontraktuese nuk shpreh ndonjë kundërshtim brenda një periudhe prej gjashtë muajsh, në vijim të datës së qarkullimit të amendamentit të propozuar nga Sekretari i Përgjithshëm.

Në këtë rast, amendamenti do të hyjë në fuqi për të gjitha Palët Kontraktuese tre muaj pas skadimit të periudhës së përmendur më sipër prej gjashtë muajsh.

3. Nëse brenda periudhës prej gjashtë muajsh referuar sipas paragrafit 2 të këtij neni, është shprehur ndonjë kundërshtim për amendamentin e propozuar, amendamenti do të gjykohet se nuk është pranuar dhe nuk do të jetë efektiv

Neni 17

Në shtesë të njoftimeve të dhëna sipas nenit 16 të kësaj Marrëveshjeje Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara do të njoftojë vendet referuar në nenin 9 paragrafi 1 dhe vendet të cilat janë bërë Palë Kontraktuese sipas nenit 9 paragrafi 2 të:

- a) nënshkruesve, ratifikuesve dhe aderuesve sipas nenit 9;
- b) datës së hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje në përputhje me nenin 10;
- c) denoncimeve sipas nenit 11;
- d) përfundimit të kësaj Marrëveshjeje në përputhje me nenin 12;
- e) njoftimit të marrë në përputhje me nenin 13;
- f) deklarimit të njoftimit të marra në përputhje me nenin 15 paragrafi 1 dhe 2;
- g) hyrjes në fuqi të çdo amendamenti ose kundërshtimin e shprehur për draftin e ndonjë amendamenti, në përputhje me nenin 16.

Neni 18

Pas 28 shkurtit 1958, origjinali i kësaj Marrëveshjeje do të depozitohet te Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, i cili do të transmetojë kopjet e certifikuara me origjinalin në çdo vend të përmendur në nenin 9 paragrafi 1 dhe 2.

Në dëshminë e të nënshkruarit të autorizuar plotësisht, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

Bërë në Gjenevë, më 13 dhjetor 1957 në një kopje të vetme në gjuhën angleze dhe atë franceze, çdo tekst është i barabartë në mënyrë autentike.

DEKRET

Nr.4207, datë 19.4.2004

PËR LEJIM LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika "c" të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Rendit Publik,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

- | | |
|---|--|
| 1. Amir Myrto Curaj | 23. Dritan Gani Halili |
| 2. Dardana Istref Kelmendi | 24. Pandeli Jani Murova |
| 3. Ermal Sotiraj Mukeli | 25. Alpin Rako Gjini |
| 4. Desard (Desart) Veis Tare | 26. Daniel Tualant Ferdinand Hodo |
| 5. Brunhilda Ferdinand Shakaj (Shingjergji) | 27. Roald Arnold Ferdinand Hodo |
| 6. Eric Eduard Shakaj | 28. Jessika Kathrin Ferdinand Hodo |
| 7. Jenny Eduard Shakaj | 29. Engjëllushe Enver Gostivari (Memishaj) |
| 8. Gentiana Haxhi Pulaj | 30. Vjollca Xhevit Reul (Troc) |
| 9. Majlinda Njac Muja (Simoni) | 31. Mirela Sotiraj Pilkati (Dimoshi) |
| 10. Erdi Hajredin Muja | 32. Adela Nexhdet Kogler (Shehu) |
| 11. Nikolla Kristofor Stergjo | 33. Artan Koço Rapo |
| 12. Lefter Alqi Gjeçka | 34. Kerstin Artan Rapo |
| 13. Dasantila Kushtrim Ritterbock (Taka) | 35. Flavia Artan Rapo |
| 14. Arben Ali Ferhati | 36. Entela Ilia Rapo (Tanellari) |
| 15. Arl Robin Arben Ferhati | 37. Gjinovefa Vahid Piechnik (Meçaj) |

16. Merita Shefqet Ferhati (Resmi)
17. Shermedin Behar Bonaj
18. Agron Bado Shakaj
19. Michael Agron Shakaj
20. Daniel Agron Shakaj
21. Ruki Kalem Shakaj (Dyrmishi)
22. Elvio Agron Shakaj

38. Genti Pandeli Borova
39. Pirro Pandeli Borova
40. Najada Xhemal Stein (Lamçe)
41. Elior Astrit Halili
42. Stela Salvator Kodheli (Kocobashi)
43. Regina Erik Kodheli
44. Nicki Nicolas Erik Kodheli

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

DEKRET
Nr.4208, datë 19.4.2004

PËR LEJIM LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika "c" të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Rendit Publik,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

- | | |
|---------------------------------------|---------------------------------------|
| 1. Gentjan Preng Ceku | 20. Elvis Luan Hoxha |
| 2. Ramazan Sulejman Hoxha | 21. Flamur Ibrahim Kosta |
| 3. Demirhan Garip Hoxha (Gucollari) | 22. Enkeleda Zef Finkelmann (Doda) |
| 4. Brunilda Xheladin Pichler (Bilali) | 23. Jan Martin Finkelmann |
| 5. Marinela Kristo Sadushi (Nano) | 24. Naim Nevruz Osmani |
| 6. Filloreta Jorgji Mukeli | 25. Emiljano Naim Osmani |
| 7. Valbona Isak Jirkovsky (Memeti) | 26. Daniels Naim Osmani |
| 8. Genci Agim Lajthia | 27. Alfred Haxhi Sinani |
| 9. Altin Bajram Keçi | 28. Arnolf Alfred Sinani |
| 10. Qefsere Ramazan Dorëzi | 30. Dallandyshe Syti Sinani (Hasanaj) |
| 11. Ilir Pandi Pishtari | 31. Flora Sefer Weberbauer (Duraj) |
| 12. Frederik Irakli Dhuli | 32. Jorida Pertef Fay (Çobani) |
| 13. Vilson Mendu Duka | 33. Lorenc Bujar Skënderi |
| 14. Fatmir Bodo Shakaj | 34. Alma Hajrullah Baier (Diglisiq) |
| 15. Vjollca Ali Gërmenji | 35. Fatmir Rushit Alimani-Schön |
| 16. Livia Gërmenji | 36. Merita Mehmet Shuaipi |
| 17. Agron Raif Palla | 37. Jürgen Hysni Mustafa |
| 18. Orges Xheladin Myrtja | 38. Amada Hysni Mustafa |
| 19. Eduard Toti Shyti | |

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

VENDIM
Nr.215, datë 16.4.2004

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.711, DATË 27.12.2001 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR STRUKTURAT DHE NIVELET E PAGAVE TË NËPUNËSVE CIVILË NË INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS QENDRORE, ADMINISTRATËS SË PRESIDENTIT DHE TË KUVENDIT DHE DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.726, DATË 21.12.2000 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË INSTITUCIONEVE BUXHETORE", NDRYSHUAR ME VENDIMET NR.39, DATË 26.1.2001, NR.158, DATË 22.3.2001, NR.167, DATË 30.3.2001, NR.174, DATË 30.3.2001, NR.197, DATË 6.4.2001, NR.358, DATË 31.5.2001 DHE NR.424, DATË 11.6.2001 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 18 e 29 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil" dhe të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Koordinimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.711, datë 27.12.2001 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Pas pikës "5" shtohet pika "5/1", me këtë përmbajtje:

"5/1 "Specialistët" apo "përgjegjësit e sektorit" në institucionet e administratës qendrore, administratës së Presidentit dhe të Kuvendit, që punojnë në pozicione që lidhen me procesin e informatizimit të veprimtarisë së administratës publike dhe kërkojnë në mënyrë të detyrueshme arsimin e lartë, në degët "inxhinieri elektronike" apo "informatikë", përfitojnë një shtesë për "kushte pune" prej 15 000 lekësh mbi pagën mujore të kategorisë përkatëse. Zbatimi i kësaj shtese për pozicionet konkrete bëhet pas miratimit paraprak të Ministrisë së Financave dhe të Departamentit të Administratës Publike, sipas përshkrimit të pozicioneve të punës."

b) Pas pikës "6" shtohet pika 6/1 me këtë përmbajtje:

"6/1 Kategorizimi për funksionet e veçanta është sipas lidhjes nr.3, e cila i bashkëlidhet vendimit dhe është pjesë përbërëse e tij."

c) Në shkronjën "a", të pikës 7, emërtesa "shef kabineti i ministrit" zëvendësohet me "drejtor i kabinetit të ministrit".

ç) Pika 11, shfuqizohet.

2. Efektet financiare për këtë vit të përballohen nga buxheti i vitit 2004, miratuar për institucionet përkatëse.

3. Vendimi nr.348, datë 27.6.2002 i Këshillit të Ministrave "Për kategorizimin e pozicioneve të punës së nëpunësve civilë në aparatin e Këshillit të Ministrave", shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

**KATEGORIZIMI I POZICIONEVE TË PUNËS PËR FUNKSIONET E VEÇANTA NË
KRYEMINISTRI DHE MINISTRITË E LINJËS**

Institucioni	Pozicioni	Kategoria e pagës
Kryeministria	Drejtor i Njesisë së Zbatimit të Projekteve të Bankës Botërore	II-a
	Drejtor i Njesisë Antikorrupsion	II-a
	Koordinator pranë Sekretarit të Përgjithshëm	II-b
	Jurist në Departamentin Juridik	II-b
	Inspektor në Departamentin e Kontrollit të Brendshëm Administrativ	II-b
	Koordinator në Departamentin e Zhvillimit të Politikave dhe Koordinimit	II-b
	Përgjegjës sektori në Departamentin e Administratës Publike	II-b
	Koordinator në Njësine të Zbatimit të Projekteve të Bankës Botërore	III-a
Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale	Drejtor i Inspektoratit Shtetëror të Punës	II-a
Ministria e Punëve të Jashtme	Përfaqësues ligjor i Zyrës së Përfaqësuesit Ligjor	II-b
	Përfaqësues i Zyrës së Minoriteteve	II-b
	Drejtor i Institutit të Diasporës	II-b
Ministria e Mjedisit	Kryeinspektor i Inspektoratit të Mjedisit	III-a
	Inspektor në Inspektoratin e Mjedisit	III-b
Ministria e Drejtësisë	Inspektor në Drejtorinë e Inspektimit Gjyqësor	III-a
Ministritë e linjës	Inspektor në Drejtoritë e Auditimit të Brendshëm apo sektorët e Auditimit të Brendshëm	III-b

URDHËR

Nr.98, datë 26.2. 2004

**MBI TARIFAT E TË ARDHURAVE DYTËSORE, TË APLIKUESHME NGA
INSTITUCIONET VARTËSE TË SISTEMIT TË BUJQËSISË DHE TË USHQIMIT**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, në zbatim të ligjit nr.7941, datë 31.5.1995 “Për ushqimin”, të ligjit nr.7674, datë 29.2.1993 “Për shërbimin dhe inspektoratin veterinar”, të ligjit nr.8732, datë 24.1.2001 “Për materialin mbjellës bimor”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.156, datë 25.4.2002 “Për organizimin dhe procedurat e kryerjes së certifikimit të materialit mbjellës bimor”, të ligjit nr.7662, datë 19.1.1993 “Për shërbimin e mbrojtjes së bimëve”, të ligjit nr.8411, datë 1.10.1998 “Për ushqimet e blegtorisë”, të ligjit nr.8409, datë 25.9.1998 “Për riprodhuesit racë-pastër dhe tufat racore në blegtori”, në bazë të ligjit nr.8691, datë 16.11.2000 “Për prodhimin dhe tregtimin e duhanit dhe cigareve” dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.223, datë 13.4.2001 “Për vlerësimin cilësor të markave të cigareve të pranishme në tregun shqiptar”, të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, si dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.424, datë 9.7.1998 “Për

krijimin dhe administrimin e të ardhurave që krijojnë institucionet buxhetore”, me propozim të Drejtorisë së Buxhetit dhe të Financës

URDHËROJ:

1. Të ardhurat që institucionet buxhetore në varësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit, sigurojnë nëpërmjet aplikimit të tarifave të shërbimeve kryesore apo veprimtarive të tjera që kryejnë për të tretët, të jenë si më poshtë:

I. Për Inspektoratin e Shërbimit të Ushqimit nëpër DBU-të në rrethe, në mbështetje të ligjit nr.7941, datë 31.5.1995 “Për ushqimin”, tarifat e shërbimit, analizimit dhe kontrolleve, të jenë:

TARIFA SHËRBIMESH

1	Marrje mostre për ekspertizë të plotë	450	Lekë
2	Ekspertizë e plotë bazuar mbi gjithë kompleksin e analizave	1500	Lekë
3	Akt vlerësimi për dhënie leje, shtyrje afati të përdorimit (garancisë) së produkteve ushqimore	2000	Lekë
4	Akt vlerësim për projekt standard eksperimental, rregull teknik	3000	Lekë
5	Pajisje me leje nga Shërbimi i Inspektoratit të Ushqimit	10000	Lekë
6	Rivlerësimi i lejeve të dhëna nga SHIU për çdo vit, për çdo leje	5000	Lekë
7	Pajisje me parastandarde ose dokumentacione të tjera nga DCIU	3000	Lekë
8	Miratim etikete për ambalazhimin e produkteve ushqimore	3000	Lekë

ÇMIMET E ANALIZAVE TË PRODUKTEVE USHQIMORE ANALITIKE

A.	PËR ANALIZAT ORGANO-SHQISORE DHE FIZIKO- KIMIKE	Çmimi në leke
	1.Marrja e mostrës	
1.1	Deri në 5 ton	300
1.2	Deri në 10 ton	350
1.3	Deri në 20 ton	450
1.4	Deri në 50 ton	500
1.5	Mbi 50 ton	1000
1.6	Për anijet dhe trenat me kapacitet mbi 100 ton	10000
	2.Treguesit organo-shqisor	450
	3.Drithi,mielli dhe produktet e tij	
3.1	Lagështia (drithi,makarona)	300
3.2	Lagështia (mielli)	270
3.3	Hiri i përgjithshëm	1200
3.4	Hiri i patretshëm HCL	1380
3.5	Aciditeti në ekstrakt alkoolik	390
3.6	Proteinat (azot i përgjithshëm)	1980
3.7	Celuloza	1260
3.8	Sheqer (i përgjithshëm dhe reduktues)	1020
3.9	Amidoni	1230
3.10	Yndyra	2130
3.11	Gluteni dhe cilësia e tij	600
3.12	Pesha ektolitrike	75
3.13	Mbisitja	150
3.14	Lëndë të huaja	225

3.15	Poroziteti i bukës	150
3.16	Rritja e vëllimit në zierje(për makaronat)	180
3.17	Papastërti, kokrra të thyera etj.	375
	4. MAJA BUKE	
4.1	Tretshmëria	50
4.2	Fuqia ngritëse	225
4.3	Lagështia	270
4.4	Aciditeti	300
	5. FRUTA PERIME E PRODUKTE TË KONSERVUARA	
5.1	Lëndë e thatë e përgjithshme	1080
5.2	Lëndë e thatë e tretshme (me refraktometër)	150
5.3	Hiri i përgjithshëm	1200
5.4	Aciditeti	300
5.5	Acidi fluoror	810
5.6	Sheqeri reduktues	1200
5.7	Sheqeri joreduktues	1200
5.8	Kripa (NaCl)	525
5.9	Vitamina C	1500
5.10	Raporti frut/lëng	330
5.11	Yndyrna	225
6.1	Lënda e thatë (me refraktometër)	120
6.2	Aciditeti	300
6.3	Gaz karbonik (me aparat)	525
6.4	Gaz karbonik (me titrim)	330
	7. QUMËSHTI DHE PRODUKTET E TIJ	
7.1	Lënda e thatë	1170
7.2	Hiri i përgjithshëm	1200
7.3	Aciditeti	270
7.4	Pesha specifike (me piknometër)	1260
7.5	Pesha specifike (me laktodensimetër)	150
7.6	Yndyra (metoda Gerber)	330
7.7	Proteina (azot i përgjithshëm)	1980
7.8	Azoti moniakal	1350
7.9	Laktoza (me Bertrand)	335
7.10	Laktoza (me Fehling)	1230
7.11	Kazeina dhe albumina	2970
7.12	Indeksi i refraksionit	270
	8. QUMËSHTI PLUHUR	
8.1	Lagështia	330
8.2	Hiri i përgjithshëm	1080
8.3	Aciditeti	270
8.4	Yndyra (me Sosklet)	2130
8.5	Numri i peroksideve	11430
8.6	Laktoza (me Bertrand)	1170
	9. GJALPI, MARGARINA	
9.1	Lagështia	750
9.2	Indeksi dhe refraksioni	270
9.3	Pika e ngurtësimit	675
9.4	PH	330
9.5	Kripa (NaCl)	525
9.6	Aciditeti	480

9.7	Papastërti të patretshme në eter	1290
9.8	Titri (margarinë)	3150
9.9	Numri i peroksideve	1140
	10. DJATHI	
10.1	Lagështia	1140
10.2	Yndyra	630
10.3	Hiri i përgjithshëm	1200
10.4	Kripa (metodën Mohr)	525
10.5	Kripa (metodën Volhard)	870
10.6	Aciditeti	270
	11. FRUTA VAJORE	
11.1	Lagështi dhe lëndë flurore	690
11.2	Yndyra (me Sosklet)	2100
11.3	Aciditeti	780
11.4	Celuloza brutto	1350
11.5	Proteina (azoti i përgjithshëm)	1980
11.6	Papastërti	375
	12. YNDYRAT (BIMORE E SHTAZORE)	
12.1	Lëndë e patretshme në eter	1290
12.2	Hiri i përgjithshëm	1200
12.3	Lagështia dhe lëndët flurore	330
12.4	Lagështia (Dean Stark)	1140
12.5	Lagështia (Karl Fisher)	2100
12.6	Aciditeti	840
12.7	Numri i sapunifikimeve	1140
12.8	Numri i jodit (metoda Hanus)	1020
12.9	Numri i peroksideve	1140
12.10	Prova Kreis	420
12.11	Indeksi i refraksionit	270
12.12	Pesha specifike (piknometër)	1260
12.13	Pesha specifike (densimetri)	150
12.14	Pesha specifike (me Mohr-Vestphal)	450
	13. SAPUNI	
13.1	Lagështia	525
13.2	Acidet yndyrore	2550
13.3	Yndyra e pasapunifikuar	1140
13.4	Alkaliniteti	1800
13.5	Karbohidratet	1800
13.6	Papastërti	1290
13.7	Kripa	525
13.8	Titri	3150
	14. SHEQERI	
14.1	Lagështia	600
14.2	Saharoza (metoda polarimetrike)	780
14.3	Sheqeri invertuar (metoda Ofner)	1020
14.4	Hiri i përgjithshëm	1200
14.5	Papastërtitë	720
14.6	PH	330
	15. PRODHIMET E SHEQERIT (BISKOTA, LLOKUME)	
15.1	Lagështia	600
15.2	Hiri i patretshëm në HCL	1380

15.3	Sheqeri i përgjithshëm (met. Manganometrike)	1500
15.4	Sheqeri reduktues	1200
15.5	Yndyra (me Sosklet)	1980
15.6	Aciditeti	270
16.1	Lagështia	270
16.2	Aciditeti	300
16.3	Hiri i përgjithshëm	1200
16.4	Amidoni (natyra e lloji i amidonit)	50
16.5	Papastërtitë	75
	17.MISH, PESHK DHE PRODUKTET E TIJ	
17.1	Lagështia	1140
17.2	Yndyra (me Sokslet)	2100
17.3	Aciditeti	270
17.4	Kripa (NaCl) me metodën (Mohr)	525
17.5	Kripa (me metodën Volhard)	870
17.6	Proteina (azot i përgjithshëm)	1980
17.7	Azoti amoniakal	1440
17.8	Nitritet	2100
17.9	Raporti mish/lëng	330
17.10	Vaj (me dekantim)	225
17.11	Prova e zierjes	375
17.12	PH	330
	18. PIJET ALKOOLIKE	
18.1	BIRRA	
18.1.1	Alkooli etilik(me piknometër)	1260
18.1.2	Ekstrakti (gradë saharometrike)	1260
18.1.3	Aciditeti	330
18.1.4	Hiri i përgjithshëm	1200
18.1.5	Gazi karbonik(me aparat)	525
18.1.6	Gazi karbonik (me tritim)	330
18.2	VERA	
18.2.1	Alkooli etilik	1260
18.2.2	Ekstrakti (me tharje)	1080
18.2.3	Ekstrakti (me piknometër)	1260
18.2.4	Aciditeti total	330
18.2.5	Aciditeti fluoror	810
18.2.6	SO ₂ i përgjithshëm	810
18.2.7	SO ₂ i lirë	625
18.3	PIJET E FORTA ALKOOLIKE	
18.3.1	Alkool etilik	1260
18.3.2	Alkool metilik	1425
18.3.3	Aciditeti	330
18.3.4	Esteret	525
18.3.5	Aldeidet	525
18.3.6	Furfurolet	780
18.3.7	Ekstrati i përgjithshëm	1080
	19. DUHAN - CIGARE	
19.1	Lagështia	525
19.2	Hiri i përgjithshëm	1200
19.3	Hiri i patretshëm në HCL	1380
19.4	Nikotina (ISO)	1650

19.5	PH	330
19.6	Lënda reduktuese totale	1200
19.7	Sheqerna të tretshme	1440
19.8	Proteina (azoti i përgjithshëm)	1950
19.9	Analiza tymi (kondesati,katrame,nikotina)	3000
	20. LETËR CIGARE	
20.1	Lagështia	525
20.2	Hiri	1200
20.3	Djegshmëria	150
20.4	Poroziteti	750
	21.FILTRI I CIGARES	
21.1	Pesha	150
21.2	Fortësia	750
21.3	Rezistenca në thithje	
B	ÇMIMET E ANALIZAVE MIKROBIOLOGJIKE	
1	Marrja e mostrës	500
2	Vrojtimi mikroskopik	300
3	Numërimi i myqeve me metodën Howard	450
4	Prova e stabilitetit për konservat	700
5	Prova e sterilitetit për konservat	700
6	Kërkimi i shkaqeve të prishjes	2000
7	Mikroflora e përgjithshme	900
8	Ngarkesa mykore totale	1000
9	Kërkimi i enterbakterieve	1000
10	Kërkimi i termofileve, aeroebe, anaerobe	900
11	Kërkimi i clostridiumin botulinum	1100
12	Kërkimi i clostridium sulfito reduktues	1100
13	Kërkimi i clostridiumpe fringens	1200
14	Kërkimi i staphylococcus	1100
15	Kërkimi i bacillus cereus	900
16	Përcaktimi i bacillus mesentericus	1000
17	Kërkimi i salmonelës	1400
18	Kërkimi i lipolitikëve	1000
19	Kërkimi i mikrokokëve	1100
20	Kërkimi i proteolitikëve	1000
21	Kërkimi i antibiotikëve	2200
22	Kërkimi i Proteus	700
23	Kërkimi i streptococcus faecalis	1300
24	Identifikimi i clostridium (gjini)	3100
25	Identifikimi i clostridium botulinum	3300
26	Identifikimi i enterokokëve(gjini)	3100
27	Identifikimi i bacileve(gjini)	3000
28	Identifikimi i baktereve laktike(gjini)	3100
29	Identifikimi i majave(gjini)	3300
30	Identifikimi i majave (specie)	4200
31	Identifikimi i myqeve (gjini)	2500
32	Identifikimi i myqeve (specie)	3300

LISTA E ÇMIMEVE TË ANALIZAVE USHQIMORE SINTETIKE

Nr.	Produkti	Analizat organo - shqisore dhe fiziko-kimike	Analizat mikrobiologjike
I	DRITHI, MIELLI DHE PRODUKTET E TYRE		
1	Drithi	2400	3000
2	Mielli	3060	3000
3	Makarona	2400	1900
4	Bukë	1695	2000
5	Niseshte	2220	-
6	Maja buke	1800	2100
II	SHEQERI DHE PRODHIMET E TIJ		
1	Sheqeri	5500	
2	Biskota	7905	
3	Karamele	5100	
4	Çokollata	7560	
5	Llokume	4050	
III	PRODUKTE TË KONSERVUARA TË FRUTA-PERIMEVE		
1	Perime e fruta të thata	1020	3200
2	Reçelna, marmalata e shurupet	2340	3000
3	Prevede	1680	3000
4	Komposto	2000	3200
5	Konserva perimesh	1755	3200
6	Salcë domate	4500	3200
7	Lëngje (të pagazuara)	3200	3200
8	Lëngje (të gazuara)	3100	-
9	Fruta e perime të freskëta	600	-
IV	FRUTA VAJORE DHE YNDYRNA		
1	Fruta vajore	3945	2500
2	Yndyrna bimore	7500	-
3	Yndyrna shtazore	8800	-
4	Margarinë	5800	-
5	Sapunë	9330	-
V	QUMËSHTI DHE PRODUKTET E TIJ		
1	Qumështi lëng	2190	3200
2	Qumështi pluhur	3180	3200
3	Kos	2190	3200
4	Gjalpë	2835	3200
5	Djathë	3915	3200
6	Gjizë	3915	3200
7	Akullore	2555	3200
VI	MISH, PESHK E PRODUKTET E TYRE		
1	Mish trup	2595	3100
2	Mish i grirë	2880	3200
3	Sallame	6315	3200
4	Konserva mishi	3405	3200
5	Konserva peshku	2800	3200

VII PIJET ALKOOLIKE			
1	Birra	4500	-
2	Vera	6000	-
PIJET E FORTA ALKOOLIKE			
a)	Raki, konjak	6500	-
b)	Fërnet, uzo, vodka etj.	4545	-
